

Haxhi Shabani

# DRITA E FJALËS

LETËRSIA 9

Për klasën e nëntë të shkollës fillore

LIBRI I MËSUESIT



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore  
PODGORICË, 2021

Haxhi Shabani

## **DRITA E FJALËS**

LETËRSIA 9

PËR KLASËN E NËNTË TË SHKOLLËS FILLORE

LIBRI I MËSUESIT

## **SVIJETLO RIJEČI**

KNJIŽEVNOST 9

PRIRUČNIK ZA DEVETI RAZRED OSNOVNE ŠKOLE

**Botuesi:** *Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë*

**Për botuesin:** *Pavle Goranoviq, drejtor*

**Kryeredaktor:** *Radulle Novoviq*

**Redaktor përgjegjës:** *Llazo Lekoviq*

**Redaktor i librit:** *Dimitrov Popoviq*

**Recensues:** *Dr. Marko Camaj  
Dr. Rrok Gjolaaj  
Valbona Hoxhiq  
Dr. Gëzim Dibra  
Mr. Ardita Kokaj*

**Korrektor:** *Dimitrov Popoviq*

**Dizajni dhe faqosja:** *studio ZUNS*

**Redaktore teknike:** *Dajana Vukçeviq*

CIP – Каталогизација у публикацији  
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-86-303-2393-5  
COBISS.CG-ID 18856708

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me vendimin nr. 19-05-119/21-6405/11 të datës 29.07.2021  
e miratoi këtë Libër të mësuesit për përdorim në shkollat fillore.

Copyright © Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2021

# PËRMBAJTJA

<b>PARATHËNIE</b> .....	5
POPULLI: <b>GJERGJ ELEZ ALIA</b> .....	6
VINÇENC PRENUSHI: <b>AMË E BI</b> .....	8
FRANÇESKO PETRARKA: <b>NGA KANCIONERA</b> .....	10
DRITËRO AGOLLI: <b>KUJDES ME FJALËN</b> .....	12
DUSHAN KOSTIQ: <b>HESHTJA E NGRIRË E VISITORIT</b> .....	14
ALI PODRIMJA: <b>DASHURIA</b> .....	16
AGIM VINCA: <b>DRILON</b> .....	18
BASRI ÇAPRIQI: <b>LËMI I ARGATËVE</b> .....	20
ANTON BERISHAJ: <b>UDHËTIMI NË BRAZIL</b> .....	22
ISMAIL KADARE: <b>GJENERALI I USHTRISË SË VDEKUR</b> .....	24
AZEM SHKRELI: <b>BUKA</b> .....	26
PETAR I P. NJEGOSH: <b>LETËRQARKORE</b> .....	28
HONORE DË BALZAK: <b>VDEKJA E GORIOIT</b> .....	30
FATOS KONGOLI: <b>NE TË TRE</b> .....	32
MEHMET KRAJA: <b>BURGU</b> .....	34
GI DË MOPASAN: <b>AI</b> .....	36
ANTON Z. ÇAJUPI: <b>14 VJEÇ DHËNDËR</b> .....	38
SAMI FRASHËRI: <b>BESA</b> .....	40
BRANISLLAV NUSHIQ: <b>PERSONI I DYSHIMTË</b> .....	43
UILLIAM SHEKSPIR: <b>ROMEO DHE ZHULIETA</b> .....	45



# PARATHËNIE

Hartimi i librit të mësuesit për klasën e nëntë të shkollës fillore për tekstin mësimor të letërsisë është një sprovë jo shumë e lehtë duke pasur parasysh dy faktorë: së pari se përvoja e shkrimit të këtyre teksteve është e re dhe së dyti, sepse autorë të librit të nxënësit janë dy autorë të tjerë.

Hartimi i këtij teksti ka një zanafillë të tij, duke pasur parasysh punën fillestare që kam bërë me shkrimin e librit të mësuesit të letërsisë për klasën e pestë të shkollës fillore. Kjo përvojë, ndonëse fillestare dhe sidomos botimet e ndryshme të autorëve shqiptarë të metodikave të gjuhës shqipe e metodave të mësimdhënies si dhe ndonjë libër i mësuesit, përkatësisht i modeleve të orëve të njësive të ndryshme nga mësues e mësuese, të cilat i kam shfletuar më kanë ndihmuar për të përshtatur e shkruar rubrikat, zhvilluar strukturën e orës, metodat dhe të arriturat e nxënës që janë përdorur për planifikimin dhe zhvillimin e njësive mësimore.

Sa më shumë që kam punuar në hartimin e këtij libri, aq më shumë puna është zhvilluar më natyrshëm. Kështu, përpos skemave që duhen përdorur në parashkrimin e njësive mësimore, për hartimin e tyre, brenda tyre janë shfrytëzuar metoda, teknika e strategji të cilat kanë ardhur si rrjedhojë logjike dhe nga natyra e lloji i tekstit letrar. Pra format e ndryshme të analizimit, interpretimit dhe zërthimit ndërtimor e përmbajtjesor janë vënë në funksion të prodhimeve letrare të autorëve të ndryshëm dhe burojnë nga veçantitë e këtyre teksteve letrare, dhe jo e kundërta kur letërsia vihet në funksion të zbatimit të teknikave e metodave mësimore.

Jam përpjekur që brenda dy-tri faqeve të jap modelin sesi mund të zhvillohet një njësi mësimore përkatësisht një tekst letrar, duke iu përshtatur, sidomos natyrës së ekzemplarit letrar, moshës së nxënësit, por njëkohësisht mënyrës sesi është zërthyer teksti letrar gjegjësisht në tekstin mësimor, pra në librin e nxënësit.

Ajo çfarë, këtë libër të mësuesit, besoj e veçon, është përdorimi i harmonizuar i metodave e teknikave, brenda një mësimi që në shumicën e rasteve nuk është një e dy, por tri e katër, varësisht prej njësisë mësimore dhe fazës së orës. Janë metoda e teknika që nxënësin e vendosin në qendër të veprimtarive, kurse mësuesi/ja qëndron në sfond dhe vepron e bashkëngjitet nga prapavija. Në të njëjtën kohë, me vendosjen e veprimtarive të nxënësve në krye të planifikimit të orës mësimore që janë të harmonizuara me pjesët e strukturës së orës, përkatësisht të metodave e teknikave të zbatuara, tregon se nxënësi është hartues, zhvillues dhe përfitues i orës mësimore. E gjithë kjo strategji që është zbatuar në hartimin e këtij libri të mësuesit, ka për synim që nxënësin tashmë ta shndërrojë në dyshues të të vërtetave absolute, pa marrë parasysh se nga vijnë, duke e shndërruar atë në ideues dhe krijues të njohurive dhe informatave. Shpresoj se sado pak në këtë drejtim të jenë bërë lëvizje përpara. Sigurisht që ky synim do të arrihet në një masë më të madhe kur edhe vetë mësues-it/et gjatë përdorimit të këtij teksti do të japin mendimin e sugjerimet e tyre në mënyrë që në botimet e ardhshme, kjo punë të avancohet edhe më shumë.

Punë të mbarë kolegë të nderuar!

Autori

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Lënda:** Gjuhë shqipe e letërsi

**Klasa:** IX

**Njësia mësimore:** Populli - Gjergj Elez Alia

## Veprimtaritë e nxënësit:

- rikujtojnë përmbledhtazi përkufizimin për këngët e epikës legjendare dhe japin shembuj të këngëve kreshnike legjendare,
- marrin si model këngën "Gjergj Elez Alia" dhe sqarojnë dallimin e lidhjet e saj me këngët e Mujit dhe Halilit,
- lexojnë tekstin dhe dallojnë pjesët tematike duke u ndalur në mënyrë të veçantë: në paraqitjen e Bajlozit, dyluftimin, vdekjen e vëllait dhe motrës,
- bëjnë përshkrimin e tipareve të personazheve: Gjergj Elez Alisë, motrës dhe Bajlozit,
- flasin për vlerat morale të Gjergj Elez Alisë, të mjedisit që përfaqëson dhe diskutojnë për kundërvlerat e Bajlozit,
- bëjnë lidhjet logjike midis vdekjes tragjike të vëllait e motrës dhe shpendit të qyqes,
- gjejnë pjesë të dialogut midis Gjergj Elez Alisë dhe Bajlozit, përkatësisht identifikojnë mjetet shprehëse si: hiperbolën e anaforën.

Metodat dhe teknikat e realizimit: diskutim për njohuritë paraprake, stuhi mendimesh, pyet sërish, punë në çifte

## Arritjet e të nxënit:

Kanë mësuar strukturën e këngëve epike legjendare, sidomos kanë arritur të analizojnë në mënyrë të veçantë këngën e Gjergj Elez Alisë: temën, personazhet, konfliktin.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, përmbledhje me këngë epike legjendare

## Struktura e orës së mësimi

Përgatitja për njësinë mësimore: diskutim për njohuritë paraprake.

Mësues-i/ ja që ka përgatitur paraprakisht në youtube përmes kompjuterit, tabletit ose celularit inkuadron fragmente të një kënge epike legjendare.

Mësues-i/ ja u shtron pyetje nxënësve për këngët epike, duke u bazuar në modelin e këngës së dëgjuar.

Shtrohen tri pyetje:

Ç' janë këngët epike legjendare?

Cilat janë këto këngë?

Cilat janë personazhet kryesore të këtyre këngëve?

Nxënësit japin përgjigje të shpejta në formë individuale.

Mund të jepen përgjigje të këtitilla të cilat në varësi të nevojës i plotëson ose sugjeron edhe mësues-i/ja.

Këngët epike legjendare rrëfejnë për histori të trimave që quhen kreshnikë, por ato nuk janë të dëshmuara me fakte historike.

Këngët kryesore epike legjendare janë këngët e Mujit e Halilit, e Aga Ymerit, e Gjon Pretikës, e Gjergj Elez Alisë etj.

Personazhet kryesore (trimat) e këtyre këngëve janë: Muji, Halili, Aga Ymeri, Gjon Pretika e Gjergj Elez Alia.

Diskutimi përqendrohet te Gjergj Elez Alia.

**Ndërtimi i njohurive:** stuhi mendimesh

Nxënësve u sugjerohet që në tekstin mësimor të këngës Gjergj Elez Alia të gjejnë fragmentet sipas këtyre pjesëve tematike: paraqitja e Bajlozit, dyluftimi midis Gjergj Elez Alisë e Bajlozit, vdekja e vëllait dhe motrës.

Mësues-i/ja nxënësve u bën këto pyetje, përkatësisht u shtron këto kërkesa:

Cilat janë tiparet e personazheve: e Gjergj Elez Alisë, motrës dhe Bajlozit?

Cilat janë vlerat morale të Gjergj Elez Alisë, të mjedisit që përfaqëson dhe kundërvlerat e Bajlozit?

Bëni lidhjet logjike midis vdekjes tragjike të vëllait e motrës dhe shpendit të qyqes.

Gjeni pjesë të dialogut midis Gjergj Elez Alisë dhe Bajlozit, përkatësisht identifikoni mjetet shprehëse si: hiperbolën e anaforën.

Pasuroni fjalorin tuaj duke lexuar kuptimin e fjalëve të panjohura në tekstin mësimor.

**Përforcimi:** pyet sërish, punë në çifte

U shpjegohet nxënësve se në këtë pjesë të orës do të punojnë në çifte sipas formës pyet sërish për këngën "Gjergj Elez Alia".

Jepen udhëzime për kërkesat:

Do të shtrohen pyetje dhe të merren përgjigje për përkufizimin e këngëve epike legjendare, cilat janë ato, personazhet kryesore, tematika e tyre, luftërat në këto këngë, parimet morale të personazheve në këngët epike legjendare, duke u përqendruar veçanërisht në këngën "Gjergj Elez Alia". (Këto kërkesa nxënësit i shkruajnë në fletore, kurse mësues-i/ja në tabelë).

Nxënësit punojnë në çifte. Njëri anëtar i çiftit lexon kërkesën, i dyti shtron pyetjen në bazë të kërkesës, kurse i pari jep përgjigje. P.sh. Pyetja: Cilat janë këngët epike legjendare? Përgjigjja: Këngët kryesore epike legjendare janë: këngët kushtuar Muajit e Halilit, Kënga e Gjon Pretikës, Kënga e Gjergj Elez Alisë dhe kështu me radhë.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Lënda:** Gjuhë shqipe e letërsi

**Klasa:** IX

**Njësia mësimore:** Vinçens Prenushi - **Amë e bi**

## **Veprimtaritë e nxënësit:**

- lexojnë me vëmendje poezinë "Amë e bi" dhe përcaktojnë elementet epike dhe lirike në të,
- gjejnë në poezi temën, përkatësisht motivin tragjik si element themelor i romancës, krahas veçorive epike e lirike,
- flasin për ndërtimin e kësaj poezie, duke u përqendruar në dialogun, personazhet dhe cilësitë e tyre,
- identifikojnë ndjenjat kryesore të personazheve si dashuria e pikëllimi, duke gjetur vargjet në të cilat shprehen ato,
- gjejnë disa nga vargjet që shprehin motivin e atdhetarisë të shqiptarët,
- diskutojnë për mjetet kryesore shprehëse në këtë poezi duke u ndalur në mënyrë të veçantë në simbolin e krahasimin,
- flasin për veçori të tjera të strukturës si rrëfimin e rrëfyesin, vetën e foljeve që përdorin personazhet,
- ndajnë poezinë në bazë të përmbajtjes, duke titulluar secilën nga pjesët.

Metodat dhe teknikat e realizimit: diskutim, ditari dypjesësh, punë në çifte

## **Arritjet e të nxënës:**

Kanë arritur të kuptojnë motivin e poezisë, duke analizuar personazhet kryesore si dhe formën letrare e mjetet figurative të cilat janë përdorur në këtë tekst letrar.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, libër i zgjedhur nga veprimtaria e Vinçens Prenushit

## **Struktura e orës së mësimimit**

Përgatitja për njësinë mësimore: diskutim për njohuritë paraprake

Mësues-i/ja u jep për detyrë nxënësve të ndajnë tekstin "Amë e bijë" në tri pjesë: në pjesën që është e shkruar në vetën e parë, në pjesën e tekstit që artikulon nëna dhe në atë që shqipton e bija.

Ngarkon tre nxënës që lexojnë më mirë, të sjellin para klasës të deklamuar tri pjesët përkatëse, duke bërë ndarjen e roleve: njëri lexon pjesën rrëfyesë, kurse dy nxënës (nëse është e mundur të realizohet) lexojnë përkatësisht njëra vargjet e nënës dhe tjetra vargjet e së bijës.

Pas këtij leximi nxënësit konstatojnë elementet lirike dhe epike në tekst si dhe përkufizimin e romancës, duke pasur për model tekstin "Amë e bijë".

## **Ndërtimi i njohurive:** ditari dypjesësh

Mësuesi u kërkon nxënësve, në një rën anë të ditarit dypjesësh të vendosin kërkesat, kurse në anën tjetër të gjejnë fragmentet në tekstin letrar që përmbajnë përdorimet konkrete të kërkesave, duke përdorur.



Kërkesat	Citatet
Shprehja e ndjenjës së trishtimit nga nëna	Do t'a dije e zeza nanë, ti vetllat shpesh m'i vrranë; Pse ç'kah mot, moj buza s't'qeshte n'argtime zemra s't'ndeshet,- Pse
Vargjet që shprehin motivin e atdhetarisë të shqiptarët	Lidhniu tok, si bajshin motit Ato bijat e Kastriotit, broh'ritni n'gzim e n'vajë: Rrnoftë Shypnija e flamuri i saj. E
Mjetet kryesore shprehëse në këtë poezi si simboli e krahasimi	Njat <u>flamur</u> si dora e saj Por dy duert <u>porsi florini</u>
Përdorimi i dialektit të gegërishtes	Kuku nana kjan me lot
Veta e parë dhe e tretë foljeve që përdorin personazhet	Kjava shumë mori lum nana... Bindej nana gja s'kuptonte...

**Përforsim:** punë në çifte, diskutim.

Nxënësit pasi lexojnë me vëmendje rubrikën e të kuptuarit të tekstit dhe mjetet shprehëse në tekstin mësimor (f. 15-16) u përgjigjen këtyre pyetjeve, pasi i kanë ndarë ato.

Secili nga çiftet përgatit përgjigjet në dy pyetje sipas renditjes. Përgjigjet i jep njëri (a) anëtare e çiftit ose të dy sipas dëshirës.

Nëse përgjigjet nuk janë të sakta, apo jo tërësisht të plota, plotësimin e bën mësues-i/ja.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Lënda:** Gjuhë shqipe e letërsi

**Klasa:** IX

**Njësia mësimore:** Françesko Petrarca - Nga Kanconiera (libri i këngëve)

## Veprimtaritë e nxënësit:

- ndahen në dy grupe të barabarta, në grupin e parë dhe të dytë,
- të dy grupet, (secili anëtar i grupit) lexojnë rubrikën shpjegime në tekstin mësimor, duke mësuar sqarimet përkatëse që janë dhënë nga pika 1-6,
- grupi i parë shpjegimet e dhëna sipas pikave përkatëse i kthen në pyetje, duke ia drejtuar grupit të dytë,
- grupi i dytë u përgjigjet pyetjeve duke i bazuar përgjigjet në rubrikën e shpjegimeve,
- lexojnë secili për vete sonetin, duke qenë të vëmendshëm të dallojnë gjendjen shpirtërore të subjektit lirik që është i përshkruar nga adhurimi për një femër,
- përgjigjen në shumicën e pyetjeve të cilat janë të parapara në tekstin shkollor në pjesën të kuptuarit e tekstit dhe mjetet shprehëse.
- lexojnë përmbajtjen e pjesëve të njësisë mësimore ku trajtohet soneti, përkatësisht eufemizmi.
- gjithashtu në formë të përmbledhur flasin për bibliografinë e poetit Françesko Petraka.

Metodat dhe teknikat e realizimit: punë në grupe, pyetje-përgjigje, stuhi mendimi

## Arritjet e të nxënës:

Kanë krijuar aftësi për të bërë analizën e këtij soneti në aspektin kuptimor, përkatësisht nëntekstin e poezisë si dhe strukturën figurative e stilistike të poezisë.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, libri i mësuesit, përmbledhja "Libri i këngëve".

## Struktura e orës së mësimi

Përgatitja për njësinë mësimore: punë në grupe

Mësues-i/ja në pajtueshmëri me nxënësit ndan klasën në dy grupe të barabarta. Secili nga anëtarët e grupit lexon me vëmendje të gjitha pikat e rubrikës shpjegime në faqen 18 të tekstit mësimor.

Mësues-i/ja i jep për detyrë grupit të parë që shumicën e shpjegimeve në kuadër të rubrikës me të njëjtin emër, t'i shndërrojnë në pyetje, kurse grupi i dytë, duke vazhduar të lexojë shpjegimet e përmendura, përgatitet për t'iu përgjigjur pyetjeve të grupit të parë.

Pjesa e orës, përgatitja për shpjegimin e njësisë së re, përfundon me pyetje-përgjigjet në mes grupit të parë dhe të dytë.

## Ndërtimi i njohurive: punë në grupe, pyetje-përgjigje

Mësues-i/ja, duke ruajtur ndarjen në dy grupe, u jep për detyrë secilit nxënës të lexojnë në heshtje poezinë sonet në tekstin mësimor, duke iu sugjeruar që të përqendrohen në gjendjen shpirtërore, përkatësisht në ndjenjat që e karakterizojnë subjektin lirik të poezisë.

Në vazhdim me sugjerimin e mësues-it/es, grupi i parë përgatitet të bëjë analizën kuptimore të kësaj poezie, duke u ndaluar posaçërisht te portreti shpirtëror dhe fizik i Laurës. Kjo problematikë trajtohet në rubrikën të kuptuarit e tekstit në pesë pikat e saj.

Grupi tjetër, punon për të analizuar pjesën teoriko-praktike të tekstit, përkatësisht figurat stilistike, duke folur me anë të konkretizimeve sipas parimit: njëherë flasin për sonetin në

aspektin teorik dhe pastaj elementet e tij i gjejnë në poezinë konkrete. Ose fillimisht gjejnë figurën në tekst e pastaj bëjnë shpjegimin e saj me anë të përkufizimit dhe veçorive të saj (Në rastin konkret kështu mund të vepohet me anë të figurës së eufemizmit).

**Përforcim:** stuhi mendimesh, detyrë shtëpie

Mësues-i/ja pyet në formë individuale të gjithë nxënësit e klasës, kurse nxënësit përgjigjen duke u përpjekur për të zbatuar teknikën e pyetje-përgjigjeve që përmbledhin njohuritë për njësinë mësimore përkatëse.

**Detyrë shtëpie:**

U jep për detyrë shtëpie esenë, e cila është e propozuar në tekstin mësimor me titullin: “E përfytyroj Laurën në mes trupave qiellorë”.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Lënda:** Gjuhë shqipe e letërsi

**Klasa:** IX

**Njësia mësimore:** Dritëro Agolli - **Kujdes me fjalën**

## **Veprimtaritë e nxënësit:**

- shprehin mendimet e tyre për fuqinë e fjalës,
- shpjegojnë kuptimin e thënies popullore: "Fjala më e rëndë se plumbi",
- arsyetojnë pse poezia "Kujdes me fjalën" është edhe një këshillë, por edhe mençuri,
- flasin për dëmin që mund të shkaktojë fjala e keqe, por edhe dobinë që mund të ketë fjala e mirë, duke pasur për bazë edhe poezinë konkrete,
- gjejnë në poezi vargjet që krijojnë mendimin se fjala duhet menduar mirë para se të flitet, duke pasur parasysh edhe thënien popullore: "Rri shtrembër e fol drejt",
- identifikojnë disa nga figurat stilistike në poezinë përkatëse si antiteza e sinonimi,
- në faqe të ndryshme të internetit gjejnë lloje të ndryshme të letërsisë popullore që për tematikë kanë rëndësinë e fjalës së dhënë,
- punojnë për detyrë shtëpie në formë hartimi temën me titullin: "Rëndësia e besës ose e fjalës së dhënë, për shqiptarët".

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimi, punë e drejtuar, punë në çifte, kërkim në internet

## **Arritjet e të nxënit:**

Dinë të interpretojnë porosinë e fuqishme të poezisë për fjalën e folur, duke iu referuar edhe rëndësisë që ka fjala e dhënë-besa për shqiptarët, për të cilët, sidomos në të kaluarën, ka qenë e ngritur në kult. Në të njëjtën kohë arrijnë të dallojnë figurat stilistike që përdor poeti për të fuqizuar kuptimin e vargut të tij.

**Mjetet mësimore:** teksti i nxënësit, libri i mësuesit, poezi të zgjedhura nga Dritëro Agolli.

## **Struktura e orës së mësimimit**

Përgatitja për njësinë mësimore: stuhi mendimi

Mësues-i/ja kërkon nga nxënësit të japin mendimet e tyre në formë të lirë sesi e kuptojnë fjalën, duke plotësuar pranë këtij emri secili nxënës nga një epitet, sipas këtij modeli:

FJALË: e mirë, e keqe, e urtë, e hidhur, e matur, e ëmbël, serioze, me mend, shkel e shko, e hidhur, e pistë,

Mësues-i/ja u sugjeron ndonjë nga thëniet popullore që në bazë kanë rëndësinë e fjalës, si aspektin pozitiv: "E ke gojën mjaltë", ashtu edhe negativ: "Fjala më e rëndë se plumbi".

Nxënësit gjejnë kuptimin e tyre si dhe përpiqen që të gjejnë ndonjë aforizëm popullor për rëndësinë dhe forcën e fjalës.

## **Ndërtimi i njohurive të reja:** punë e drejtuar, punë në çifte

Mësues-i/ja ngre në këmbë tre nxënës/e që dinë të recitojnë mirë, që pasi secili për vete e lexon poezinë përkatëse, e deklamojnë para klasës njëri pas tjetrit.

Nxënësit e tjerë, në ndërkohë, janë ndarë në çifte dhe kanë dëgjuar me vëmendje poezinë e recituar.

Sipas ndarjes me ndihmën e mësues-it/es, gjysma e çifteve përgatiten të arsyetojnë sesi ndikojnë fjalët e mira (qëndrimi pozitiv) dhe fjalët e këqija (qëndrimin negativ) ndaj njerëzve.

Çiftet bëjnë prezantimin e punës së tyre.

**Përforcim:** kërkim në internet

Mësues-i/ja këshillon nxënësit që të gjejnë në internet lloje të ndryshme të letërsisë popullore dhe ndonjë film që ka për tematikë rëndësinë e fjalës, përkatësisht besës.

**Detyrë shtëpie:**

U jep për detyrë shtëpie temën që ka në qendër rëndësinë e ruajtjes së fjalës së dhënë-besës nga shqiptarët. "Rëndësia e besës ose e fjalës së dhënë, për shqiptarët".

U sugjeron që me këtë temë ekzistojnë balada, filma e pjesë teatrale shqiptare.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Lënda:** Gjuhë shqipe e letërsi

**Klasa:** IX

**Njësia mësimore:** Dushan Kostiq - Heshtja e ngrirë e Vizitorit

## Veprimtaritë e nxënësit:

- flasin në mënyrë të lirë sesi e kuptojnë titullin e poezisë "Heshtja e ngrirë e Vizitorit"
- lexojnë strofën e parë të poezisë, që i ndihmon shumë për shpjegimin e titullit të vjershës
- shpjegojnë kuptimin e titullit të poezisë, duke u bazuar në zbërthimin e domethënies së strofës së parë dhe kuptimeve të përgjithshme të fjalëve: heshtje, vetmi, mall, dhimbje.
- lexojnë në tërësi poezinë, duke u përqendruar në ndjenjën themelore që përshkohet heroit lirik i kësaj poezie.
- sjellin shembuj të mjediseve rurale, të cilat janë të braktisura, si rezultat i shpërnguljeve të popullatës duke iu referuar mjedisit jetësor që e sjell poeti në poezi, i cili është i braktisur,
- flasin për mënyrën sesi është e pasqyruar vendlindja në poezinë përkatëse dhe si e parafytyrojnë vetë nxënësit.
- diskutojnë për mjetet shprehëse kryesore në këtë poezi si: onomatopeja, antiteza, duke iu referuar edhe rubrikës përkatëse në Tekstin mësimor.

Metodat dhe teknikat e realizimit: shkrimi i lirë, diskutim, lexim i poezisë, pyetje-përgjigje, detyrë shtëpie

## Arritjet e të nxënës:

Kanë kuptuar pasojat që i shkaktohen një vendi, kur nga ai shpërngulet popullata e tij, që del fuqimisht në këtë poezi, duke lënë pas heshtjen, boshllëkun, vetminë mallin, dhimbjen etj. Gjithashtu kanë arritur të analizojnë gjendjen shpirtërore e emocionale të heroit lirik (të poetit).

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, libri i mësuesit në internet.

## Struktura e orës së mësimimit

Përgatitja për njësinë mësimore: shkrim i lirë

Mësues-i/ja, pasi ka zgjedhur më përpara, një video material me kuadro nga një vend i braktisur që shoqërohet me një muzikë melankolike, së bashku me nxënësit shikon këtë video. Menjëherë pasi nxënësit e shikojnë videon, u jep për detyrë që të shkruajnë nga një fjali për të shprehur emocionin kryesor që ndjenë gjatë shikimit të materialit përkatës.

Nxënësit më pastaj lexojnë fjalitë e tyre, por nuk i gjejnë mendimet përkatëse.

## Ndërtimi i njohurive të reja: diskutim, lexim i poezisë

Nxënësit me sugjerimin e mësues-it/es përpiqen të zbërthejnë titullin e poezisë, duke pasur parasysh kuptimin leksikor të fjalëve: vetmi, heshtje, mall, braktisje.

Dy-tre nxënës lexojnë njëri pas tjetrit strofën e parë të poezisë, e cila u ndihmon për të thënë shpjegimet dhe mendimet e tyre për titullin dhe motivin themelor të poezisë.

Nxënësit japin shembuj të mjediseve rurale, që janë të braktisura, si rezultat i shpërnguljeve të popullatës duke iu referuar mjedisit jetësor që e shfaq poeti në poezi, i cili është i braktisur.

-Ata flasin për mënyrën sesi është e pasqyruar vendlindja në poezinë përkatëse dhe si e

parafytyrojnë vetë nxënësit.

Mësues-i/ja, u jep për detyrë të gjithë nxënësve që të gjejnë ndjenjën themelore me të cilën përshkohet tërë poezia, por paraprakisht u sugjeron atyre që poezinë ta lexojë secili për vete dhe më pastaj të shprehin mendimet e tyre.

Nxënësit në vazhdim, punojnë pjesën e rubrikës për mjetet shprehëse në tekstin mësimor, duke u përqendruar sidomos te onomatopeja dhe antiteza. Ata plotësojnë edhe pyetjet e tjera që janë të parapara në rubrikën e përmendur.

**Përforcim:** pyetje-përgjigje, detyrë shtëpie

Nxënësit, duke iu drejtuar njëri-tjetrit, pyetjet dhe përgjigjet sesi është shfaqur vendlindja në poezinë përkatëse dhe si e përshkruajnë ata vetë vendlindjen e tyre, përcaktojnë temën e një eseje që do ta shkruajnë në shtëpi.

**Detyrë shtëpie:**

Titulli i esesë mund të jetë: "Vendlindja ime, si është dhe si do ta doja".

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Lënda:** Gjuhë shqipe e letërsi

**Klasa:** IX

**Njësia mësimore:** Ali Podrimja - Dashuria

## **Veprimtaritë e nxënësit:**

- ndahen në tri grupe të barabarta,
- grupi i parë lexon disa herë me vëmendje në tekstin mësimor, në faqen 28 pjesën njohje dhe vargu i lirë,
- grupi i dytë lexon disa herë me vëmendje në tekstin mësimor në faqen 28 pikat nga 1-5 në kuadër të rubrikës Të kuptuarit e tekstit dhe mjetet shprehëse,
- grupi i tretë lexon disa herë me vëmendje në tekstin mësimor në faqen 29 pikat nga 7-12 në kuadër të rubrikës të kuptuarit e tekstit dhe mjetet shprehëse,
- pas rreth 20 minutave punë një nga përfaqësuesit e grupeve ose sipas marrëveshjes disa nga ata prezantojnë punën e tyre përpara klasës, duke folur për pjesën përkatëse që e kanë përgatitur,
- secili grup gjatë prezantimit të pjesës, shpjegimet e veta i bazon në tekstin poetik "Dashuria" nga Ali Podrimja.

Metodat dhe teknikat e realizimit: punë në grupe, lexim në heshtje,

## **Arritjet e të nxënit:**

Kanë arritur të kuptojnë dhe të flasin për motivin themelor të poezisë që është dashuria, përkatësisht mjetet kryesore shprehëse të poezisë si simbolin, anaforën etj. Gjithashtu dinë të flasin për elementet bazë të analizës ndërtimore të poezisë siç janë: heroi lirik i saj e vargu i lirë.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, poezi të Ali Podrimjes në internet

## **Struktura e orës së mësimimit**

Përgatitja për njësinë mësimore: ndarje në grupe, lexim në heshtje, përmbledhje e mësimimit  
Nxënësit në bashkëpunim me mësues-in/en ndahen në tri grupe dhe lexojnë disa herë pjesët përkatëse në tekstin mësimor.

Grupi i parë: lexon disa herë me vëmendje në tekstin mësimor, në faqen 28, pjesën njohje dhe vargu i lirë. Grupi i dytë lexon disa herë me vëmendje në tekstin mësimor në faqen 28, pikat nga 1-5 në kuadër të rubrikës të kuptuarit e tekstit dhe mjetet shprehëse dhe grupi i tretë lexon disa herë me vëmendje në tekstin mësimor në faqen 29 pikat nga 7-12 në kuadër të rubrikës së përmendur.

## **Ndërtimi i njohurive të reja:** punë në grupe, prezantimi i punës së grupeve

U jepet kohë e mjaftueshme që grupet të përgatisin pjesët e ndara nga njësia mësimore, afërsisht rreth 20 minuta.

Mësues-i/ja u sugjeron grupeve që shpjegimet e tyre për pjesën që do ta prezantojnë përpara klasës, ta bazojnë me shembuj konkretë nga poezia përkatëse. Secili grup paraqet punën e vet, sipas dëshirës, duke marrë pjesë një nxënës në emër të grupit, apo disa nga ata.

Pas prezantimit në emër të grupeve flet një përfaqësues për nivelin e prezantimit të grupit tjetër. Më pastaj, po ashtu një nxënës në emër të grupit vlerëson se cilët nga dy grupet e kanë realizuar më mirë shpjegimin e pjesës së njësisë mësimore. Grupi që merr më shumë pikë shpallet fitues.



**Përforcim:** përmbledhje e mësimit

Mësues-i/ja për njësinë mësimore pyet më shumë nxënësit që janë treguar më pak aktivë gjatë ndërtimit të njohurive të reja, duke u shtruar pyetjet themelore për këtë njësi mësimore. Nxënësit përgjigjen sipas mundësive të tyre. Në rastet ku është nevoja, mësues-i/ja ndërhyr duke plotësuar ose saktësuar përgjigjet.

**Detyrë shtëpie:**

Nxënësve u jepet detyra e shtëpisë nga teksti mësimor me titullin: “Për të kapërcyer pengesat, duhet guxim”.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Lënda:** Gjuhë shqipe e letërsi

**Klasa:** IX

**Njësia mësimore:** Agim Vinca - Drilon

## Veprimtaritë e nxënësit:

- përgjigjen në pyetjet enigmë drejtuar nga mësues-i/ja që ka përgatitur në formë të skedave për tre lumenj shqiptarë,
- flasin në mënyrë të lirë për veçoritë e këtyre lumenjve, duke u ndaluar edhe te specifikat dhe bukuritë e tyre,
- lexojnë pjesën njohje në tekstin mësimor, faqja 30 dhe japin përgjigje për vendndodhjen e lumit Drilon, si dhe për lirikën e peizazhit,
- dy nga nxënësit që dinë të bëjnë lexim shprehës recitojnë poezinë "Drilon",
- secili-a nga nxënës-it/et lexojnë pyetjet, përkatësisht kërkesat në kuadër të rubrikës të kuptuarit e tekstit dhe mjetet shprehëse,
- duke pasuar parasysh tekstin e poezisë, pyetjet dhe kërkesat e përmendura, shkruajnë në klasë 10-12 fjali në prozë, (ese të shkurtër), për poezinë "Drilon",
- disa nga nxënësit lexojnë tekstin e shkruar,
- japin mendime për tekstet e lexuara, duke e krahasuar edhe me tekstin që përkatësisht ka shkruar nxënësi që shprehet.

Metodat dhe teknikat e realizimit: minikonkurs, lexim shprehës e të lirë, shkrim individual me baza referenciale, diskutim

## Arritjet e të nxënës:

Kanë krijuar aftësi për të folur për tekstin (përmbajtjen) dhe nëntekstin (mjetet figurative) të poezisë "Drilon" nga Agim Vinca.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, libri i mësuesit, poezi nga Agim Vinca në internet.

## Struktura e orës së mësimimit

Përgatitja për njësinë mësimore: minikonkurs, lexim shprehës e të lirë, shkrim individual me baza referenciale

Ora mësimore nis me një minikonkurs. Mësues-i/ja ka përgatitur 3 skeda në të cilat ka shkruar pyetjet - sqarimet enigma për 3 lumenj shqiptarë: lumi Buna, lumi Shkumbin dhe lumi Drilon.

Pyetjet-sqarimet i thotë mësues-i/ja njëra pas tjetrës, sipas modelit që sa më shumë pyetje-sqarime të thuhet, aq më lehtë është për të zbuluar pyetjen enigmë për lumin përkatës.

Pyetjet, apo sqarimet për të gjetur lumin bëhen deri sa të gjendet se për cilin lumë është fjala. Në raste të veçanta, nëse nxënësit nuk e gjejnë atëherë emrin e tij e tregojnë mësues-i/ja.

P. sh. për lumin Buna: Cili është lumi që buron në një liqen, lumi që është i shtrirë në dy shtete, lumi që rrethon në tri anë një ujdhesë që gjendet në Ulqin etj.

Në rastin konkret pritet që më vështirë nxënësit do ta kenë për lumin Drilon, sepse është më pak i njohur se dy lumenjtë e parë.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** lexim shprehës e të lirë, shkrim individual me baza referenciale

Mësues-i/ja cakton dy nxënës që dinë të lexojnë në mënyrë shprehëse për të deklamuar poezinë përkatëse, kurse nxënësit e tjerë dëgjojnë me vëmendje.

Më pastaj të gjithë nxënësit lexojnë pyetjet, përkatësisht kërkesat në kuadër të rubrikës të kuptuarit e tekstit dhe mjetet shprehëse.

Duke pasur parasysh tekstin e poezisë, pyetjet dhe kërkesat e përmendura, secili në mënyrë individuale shkruan në klasë një tekst në prozë, ese të shkurtër), për poezinë "Drilon",

**Përforcim:** lexim teksti, diskutim

Disa nga nxënësit lexojnë tekstin e shkruar, kurse të tjerët japin mendime për tekstet e lexuara, duke i krahasuar edhe me ato që kanë shkruar edhe ata vetë.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Lënda:** Gjuhë shqipe e letërsi

**Klasa:** IX

**Njësia mësimore:** Basri Çapriqi - Lëmi i argatëve

## Veprimtaritë e nxënësit:

- flasin se çfarë dinë për punëtorët e krahut (argatët),
- konkretizojnë secili (a) se çka punojnë, për sa punojnë, cili është qëndrimi i të tjerëve ndaj tyre,
- lexojnë në heshtje poezinë "Lëmi i argatëve", pastaj sipas dëshirës një nga nxënësit e deklamon atë me zë, përpara klasës,
- duke shfrytëzuar shumicën e pyetjeve të përfshira në tekstin mësimor në rubrikën të kuptuarit e tekstit dhe mjetet shprehëse i shtrojnë pyetje njëri-tjetrit dhe japin përgjigje sesi në një lirikë shoqërore trajtohet shtresa shoqërore e punëtorëve të krahut (argatëve),
- përpiqen të shpjegojnë në mënyrë të veçantë vargjet: "burra me shtatë-tetë fëmijë", "ju s'keni fuqi as sa një fëmijë", ju që vazhdimisht mbeteni në klasë".
- hartojnë edhe pyetje të tjera, përgjigjet e të cilave duan t'i dinë për këtë shtresë shoqërore,
- bëjnë pyetje sesi mund të zgjidhet statusi e pozita e tyre në mënyrë afatgjatë,
- përpiqen që të japin përgjigjet sipas mendimit të tyre,
- kërkojnë nga mësues-i/ja që të shprehë mendimin për këtë problem të mprehtë shoqëror.

Metodat dhe teknikat e realizimit: diskutim, lexim në heshtje, di, dua të di, mësova, pyetje-përgjigje, detyrë shtëpie

## Arritjet e të nxënës:

Kanë krijuar shkathtësi për të shtruar problemet shoqërore të pozitës së punëtorëve të krahut, duke parë specifikat sesi trajtohen në poezinë përkatëse, përgjithësisht në shoqëri dhe kanë krijuar njohuri sesi mund të zgjidhet ky problem në të ardhmen.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, poezi të tjera të këtij poeti në internet ose nga ndonjë libër i tij.

## Struktura e orës së mësimi

Përgatitja për njësinë mësimore: diskutim, lexim në heshtje

Mësues-i/ja këshillon nxënësit që të diskutojnë në mënyrë të lirë për punëtorët e krahut: çka punojnë, për sa punojnë, si vishen, si sillen, a ka ndonjë vend në vendin, qytetin e nxënësve se ku rrinë ata, kush janë dhe nga janë, cili është qëndrimi i të tjerëve ndaj tyre.

Secili (a) nga nxënës-it (et) lexojnë në heshtje poezinë "Lëmi i argatëve" që gjendet në tekstin shkollor.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** lexim i poezisë, di, dua të di, mësova

Nxënësit shfrytëzojnë shumicën e pyetjeve të përfshira në tekstin mësimor në rubrikën të kuptuarit e tekstit dhe mjetet shprehëse.

I shtrojnë pyetje njëri-tjetrit dhe japin përgjigje sesi në një lirikë shoqërore trajtohet shtresa shoqërore e punëtorëve të krahut (argatëve),

Për të trajtuar në disa aspekte këtë njësi mësimore mund të përdoret metoda: di, dua të di, mësova.

Di:

Punëtorët e krahut punojnë punët më të rënda.

Zakonisht punojnë për një mëditje të vogël.

Janë të veshur keq. Nuk janë nga qyteti (fshati im).

Shumica e njerëzve që i marrin sillen mirë me ta, por ka raste edhe që i nënçmojnë.

Dua të di:

Ç'është lirika shoqërore? Cilat janë të veçantat e poezisë së Basri Çapriqit në trajtimin e temës së punëtorëve të krahut në poezinë "Lëmi i argatëve"? Shpjegoni kuptimin e vargjeve: "burra me shtatë-tetë fëmijë", "ju s'keni fuqi as sa një fëmijë", "ju që vazhdimisht mbeteni në klasë". Çfarë duhet bërë që të zgjidhet statusi i kësaj shtrese shoqërore?

Mësova: Lirika shoqërore, është një nga llojet e lirikës që trajton tema, motive e probleme që janë reale në shoqëri. Poeti Basri Çapriqi në poezinë "Lëmi i argatëve", jep portretin real të punëtorëve të krahut, argatëve, të cilët kanë probleme për të siguruar të ardhurat elementare për vete dhe familjet e tyre. Punëtorët e krahut kanë shumë fëmijë, nuk kanë fuqi, sepse nuk i kanë të zgjidhura problemet sociale të tyre dhe kanë qenë nxënës jo të mirë, jo thjesht në shkollë, por nuk dinë të zgjidhin në nivelin e duhur as problemet e jetës, nuk kanë para të mjaftueshme për të jetuar normalisht. Shteti, përkatësisht shoqëria e bashkësia vendore duhet të vërë në jetë politikën e duhura shoqërore që statusi e pozita e punëtorëve të krahut të zgjidhet, duke krijuar kushte dinjitoze për jetën e tyre dhe të familjeve që kanë.

**Përforsim:** pyetje-përgjigje

**Detyrë shtëpie:**

Nxënësit, pasi bëjnë një përsëritje të përmbledhur të kësaj njësie mësimore, mësues-i/ja u jep detyrën e shtëpisë me temën: "Varfëria, problem shoqëror që do zgjidhje".

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Lënda:** Gjuhë shqipe e letërsi

**Klasa:** IX

**Njësia mësimore:** Anton Berishaj - Udhëtimi në Brazil

## Veprimtaritë e nxënësit:

- gjejnë poezi të cilat u kushtohen ndonjë personaliteti të njohur historik, kulturor apo artistik,
- flasin për mënyrën sesi trajtohen personalitetet përkatëse në poezi,
- gjejnë në tekstin mësimor poezinë "Udhëtimi në Brazil" shkruar nga Anton Berishaj,
- lexojnë secili/a për vete nga disa herë poezinë konkrete në tekstin mësimor,
- lexojnë pjesën njohje në tekstin mësimor dhe rubrikën në formë pyetje-kërkesave të kuptuarit e tekstit dhe mjetet shprehëse,
- përgjigjen në pyetjet dhe kërkesat, përfshirë në pikat 1-11 në tekstin mësimor të rubrikës së përmendur.
- flasin për mënyrat e ndryshme të të kuptuarit të kësaj poezie, përkatësisht mundësive të ndryshme për interpretimin e saj dhe letërsisë përgjithësisht,
- me ndihmën e mësues-it/es diskutojnë për dukurinë e studiuesve poetë dhe poetëve studiues, duke iu referuar shembullit të Anton Berishajt.

Metodat dhe teknikat e realizimit: diskutim, lexim i poezisë dhe i tekstit sqarues për të, interpretim i poezisë.

## Arritjet e të nxënit:

Kanë krijuar aftësi për analizuar nëntekstin e poezisë përkatëse, duke kuptuar se mënyrat e interpretimit, sidomos të poezisë janë relative dhe nuk ekziston vetëm një mënyrë analize, por ka të ndryshme.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, libri i mësuesit në formë elektronike.

## Struktura e orës së mësimimit

Përgatitja për njësinë mësimore: diskutim

Mësues-i/ja kërkon nga nxënësit të flasin për ndonjë poezi autoriale ose popullore, e cila i kushtohet ndonjë personaliteti të njohur të historisë, të kulturës ose të artit.

Nxënësit shprehen të lirë për ndonjë poezi të tillë, kurse mësues-i/ja pohon se një poezi të atillë, kushtuar shkrimtarit arbëresh, Zef Serembe, do ta mësojnë gjatë orës përkatëse.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** lexim i poezisë dhe i tekstit sqarues për të, interpretim i poezisë

Mësues-i/ja u sugjeron nxënësve të lexojnë secili/a për vete nga disa herë poezinë konkrete në tekstin mësimor.

Më pastaj lexojnë rubrikën në formën e pyetje-kërkesave të *kuptuarit e tekstit dhe mjetet shprehëse* dhe përpiqen që të përgjigjen në pyetjet e kërkesat, përfshirë pikat 1-11 në tekstin mësimor të rubrikës së përmendur.

Me nismën e mësues-it/es nxënësit flasin për mënyrat e ndryshme të të kuptuarit të kësaj poezie, përkatësisht për mundësitë e ndryshme të interpretimit të saj dhe letërsisë përgjithësisht.

Kjo mundësi vë në plan të parë jo vetëm vlerat e krijimit të letërsisë origjinale, por edhe të interpretimit të ndryshëm të saj.

**Përforcim:** diskutim

Me ndihmën e mësues-it/es, nxënësit diskutojnë për dukurinë e studiuesve poetë dhe poetëve studiues, duke iu referuar shembullit të studiuesit e poetit Anton Berishaj. Kjo dukuri nënkupton veprimtarinë e autorëve të ndryshëm, që para së gjithash janë studiues të letërsisë, por janë edhe krijues të saj dhe anasjelltas.

Marrin edhe shembuj të tjerë në letërsinë shqipe, siç është shkrimtari dhe studiuesi Rexhep Qosja dhe ndonjë shembull tjetër.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Lënda:** Gjuhë shqipe e letërsi

**Klasa:** IX

**Njësia mësimore:** Ismail Kadare - **Gjenerali i ushtrisë së vdekur**

## **Veprimtaritë e nxënësit:**

- një nga nxënësit lexon sipas dëshirës të dhënat për jetën dhe veprën e shkrimtarit Ismail Kadare në tekstin mësimor,
- flasin për krijimtarinë e autorit duke u përqendruar në fushat e ndryshme ku ka dhënë ndihmesën e tij autori,
- shquajnë sidomos romanet e tij, duke veçuar romanin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur",
- lexojnë fragmentin e romanit që është përfshirë në tekstin mësimor.
- ndahen në tri grupe:
- grupi i parë merr përsipër të përgatisë sesi mund të zbërthehet, studiohet pjesa e romanit, përfshirë në pikën 10, duke u bazuar në pyetjet dhe kërkesat në tekstin mësimor: pikat 10-18,
- grupi i dytë përgatit analizën teorike të fragmentit të përmendur të romanit, duke iu referuar pjesës teorike në tekstin mësimor,
- grupi i tretë përgatit përgjigjet në pyetje-kërkesat, të përfshira në pikat 1-9.

Metodat dhe teknikat e realizimit: lexim i bibliografisë së autorit, përmbledhje e veprimtarisë së tij, studim teksti, analizë teorike, punë dhe garë në grupe

## **Arritjet e të nxënit:**

Kanë arritur të bëjnë studimin e fragmentit të tekstit dhe analizën teorike të tij; pra të mjekteve shprehëse duke bërë edhe krahasimin midis formave të ndryshme të letërsisë- romanit dhe artit-filmit në rastin konkret midis "Gjeneralit të ushtrisë së vdekur", roman dhe film.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, libri i mësuesit në formë elektronike, romani "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", një nga filmat shqiptarë xhiruar me motivet e romanit përkatës.

## **Struktura e orës së mësimimit**

Përgatitja për njësinë mësimore: lexim i bibliografisë së autorit, përmbledhje e veprimtarisë së tij.

Mësues-i/ja sugjeron që të lexohet bibliografia e shkrimtarit Ismail Kadare në tekstin mësimor.

Flasin për krijimtarinë e autorit duke u përqendruar në fushat e ndryshme ku ka dhënë ndihmesën e tij autori, duke shquar sidomos romanet e tij dhe veçuar romanin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur".

**Ndërtimi i njohurive të reja:** studim teksti, analizë teorike, punë dhe garë në grupe,

Sipas dëshirës, disa nxënës lexojnë në mënyrë shprehëse fragmentin e romanit që është përfshirë në tekstin mësimor.

Klasa ndahet në katër grupe të barabarta. Grupi i parë merr përsipër të përgatisë sesi mund të zbërthehet, studiohet pjesa e romanit, përfshirë në pikën 10 në kuadër të rubrikës të *kuptuarit e tekstit dhe mjetet shprehëse*, duke u bazuar në pyetjet dhe kërkesat në tekstin mësimor: pikat 10-18. Grupi i dytë përgatit analizën teorike të fragmentit të përmendur të romanit, duke iu referuar pjesës teorike në tekstin mësimor. Grupi i tretë përgatit përgjigjet në



pyetje-kërkesat, të përfshira në pikat 1-9.

Secili nga grupet bën prezantimin e punës së tyre. Më pastaj bëhet votimi për grupin më të mirë. Edhe mësues-i/ja jep mendimin e tij (saj), në fund, por nuk ka të drejtë vote.

**Përforsim:** detyrë shtëpie, shikim filmi

**Detyrë shtëpie:**

Mësues-i/ja u jep detyrë shtëpie nxënësve për të shikuar një nga filmat shqiptarë të xhiruar sipas motiveve të romanit "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", duke shkruar për ndryshimet midis filmit dhe romanit.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Lënda:** Gjuhë shqipe e letërsi

**Klasa:** IX

**Njësia mësimore:** Azem Shkreli - **Buka**

## **Veprimtaritë e nxënësit:**

- nxënësit japin mendimin e tyre për kuptimin e titullit të tregimit "Buka",
- lexojnë fragmente të zgjedhura dhe u përgjigjen pyetjeve që kanë për bazë përmbajtjen e tyre,
- përipiqen të parashikojnë ngjarjet në vazhdim të tregimit, pas përfundimit të fragmenteve përkatëse që lexohen,
- zbërthejnë gjendjen emocionale të personazhit kryesor duke iu referuar pjesës së fragmentit konkret,
- u përgjigjen pyetjeve, të përfshira në tekstin mësimor për mjetet shprehëse të këtij tregimi,
- punojnë për zgjerimin e fjalorit të tyre, duke parë po në tekstin mësimor kuptimin e fjalëve të panjohura në tregimin përkatës.

Metodat dhe teknikat e realizimit: diskutim, DRTA (lexim e mendim i drejtuar), punë me leksikun, analizë e mjeteve shprehëse,

## **Arritjet e të nxënësve:**

Krijojnë shkathësi për t'iu përgjigjur pyetjeve për tregimin përkatës, si në aspektin e përmbajtjes, kuptimitin e temës, gjendjen emocionale të personazhit, fatin e tij si dhe arrijnë të kuptojnë tregimin si formë letrare dhe të gjejnë figurat kryesore stilistike.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, libri i mësuesit në internet, përvojat e nxënësve.

## **Struktura e orës së mësimimit**

Përgatitje për njësinë mësimore: diskutim

Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e tregimit të Azem Shkrelit "Buka".

Kërkon nga nxënësit të japin mendimin e tyre se çka nënkuptojnë me këtë titull. Nxënësit shprehin mendimet e tyre të lira, kurse mësues-i/ja, nëse është e nevojshme, saktëson ose plotëson përgjigjet duke u sugjeruar atyre se gjatë orës përkatëse do të mësojnë tregimin, i cili ka për temë kryesore, sigurimin e bukës së gojës, përkatësisht ushqimin kryesor.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** DRTA (lexim e mendim i drejtuar), punë me leksikun, analizë e mjeteve shprehëse

Nxënësit lexojnë një nga një fragmentet e tregimit. Pas çdo leximi të fragmentit, mësues-i/ja u shtron pyetje nxënësve, por edhe ata njëri-tjetrit, duke pasur parasysh përmbajtjen dhe formën e tekstit. Pas çdo pyetjeje, nxënësve u lihet kohë për të menduar dhe pastaj japin përgjigjet e tyre të lira duke bërë edhe parashikimet e tyre se çfarë do të ndodhë në vazhdim.

Fragmenti i parë i tregimit: *Kur ndjente dhembje...deri te...kah thepat e majeve.*

Përshkruaj pamjen e jashtme të personazhit kryesor në këtë tregim.

Pse ai shikon renë në qiell?

Fragmenti i dytë i tregimit: *Përmbi të ecte... deri te...tani mezi shihet.*

Me kë krahasohen retë në këtë tregim?

Në cilën stinë reja mezi shihet?

Fragmenti i tretë i tregimit: *Ndërsa shikonte çërlekun...deri te...kryq e tërthorë arës.*

Përshkruani sesi bie breshëri?

Çfarë dëmi shkaktoi breshëri?

Analizoni gjendjen shpirtërore të Balës në këtë fragment.

Fragmenti i katërt i tregimit: *Bala heshtte...deri te...në magje dhe qante.*

Analizoni nëntekstin e pjesës së këtij fragmenti: *Bala heshtte. Endej nëpër arë, i kapte një nga një kallinjtë e përkulur, i zgjonte. I mbante për fletësh si ushtarë të rrëzuar...*

Analizoni këtë fjali: *Balë! Në dorë të Zotit qofsh!*

Mësues-i/ja u sugjeron nxënësve që t'u përgjigjen pyetjeve, në tekstin mësimor, për mjetet shprehëse të këtij tregimi.

Gjithashtu nxënësit punojnë për zgjerimin e fjalorit të tyre, duke parë po në tekstin mësimor kuptimin e fjalëve të panjohura në tregimin përkatës.

**Përforcim:** detyrë shtëpie

**Detyrë shtëpie:**

Mësues-i/ja u jep nxënësve detyrën e shtëpisë "Ironia e fatit" që është e paraparë në tekstin shkollor të njësisë mësimore përkatëse, duke iu referuar temës së tregimit: Në bazë të nevojës mësues-i/ja u jep sqarimet e duhura për këtë temë nxënësve.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Lënda:** Gjuhë shqipe e letërsi

**Klasa:** IX

**Njësia mësimore:** Petar I Petroviq Njegosh - Letërçarkore

## Veprimtaritë e nxënësit:

- lexojnë të dhënat për jetën e veprat e autorit në tekstin mësimor,
- flasin për vlerat njerëzore që kanë fetë përgjithësisht dhe njerëzit që përfaqësojnë fetë e ndryshme, të cilat janë të përhershme,
- secili nga nxënësit lexon tekstin e "Letërçarkores"
- tekstin "Letërçarkore" e ndajnë në 4 pjesë sipas këtyre tematikave: 1. Përkushtimi ndaj lirisë, 2. Rrezikimi i lirisë, 3. Ndëshkimi i shkelësve, 4. Lavdia e paqedashësve dhe liridashësve,
- ndahen në katër grupe, për të analizuar mesazhet, sipas tematikave të përcaktuara,
- secili grup flet për mesazhin e pjesëve të "Letërçarkores", duke zbërthyer vlerat njerëzore, morale, kombëtare dhe popullore të lirisë, paqes, luftën kundër rrezikuesve të këtyre vlerave.

Metodat dhe teknikat e realizimit: punë në grupe, analizë e tekstit sipas tematikës, stuhi mendimi

## Arritjet e të nxënit:

Nxënësit kanë arritur të kuptojnë dhe analizojnë mesazhet e tekstit dedikues "Letërçarkorja" për funksionimin e një vendi, përkatësisht banorëve të tij si dhe vlerat morale, njerëzore dhe qytetare të lirisë, paqes e mirëkuptimit midis njerëzve, në të kaluarën dhe aktualisht.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, libri i mësuesit në internet

## Struktura e orës së mësimimit

Përgatitja për njësinë mësimore: njohje e jetës së autorit

Përmes leximit të shënimeve për autorin nxënësit njohin përmbledhtazi jetën e Petar I Petroviq Njegoshit si udhëheqës fetar e shtetëror, historian e autor i disa letërçarkoreve.

Ata vënë në dukje vlerat njerëzore që kanë fetë përgjithësisht dhe njerëzit që përfaqësojnë fetë e ndryshme, të cilat janë të përhershme siç janë besimi, paqja dhe mirëkuptimi midis njerëzve.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** punë në grupe, analizë e tekstit sipas tematikës

Mësues-i/ja u kërkon nxënësve që tekstin "Letërçarkorja" ta ndajnë në 4 pjesë sipas këtyre tematikave: 1. Përkushtimi ndaj lirisë, 2. Rrezikimi i lirisë, 3. Ndëshkimi i shkelësve, 4. Lavdia e paqedashësve dhe liridashësve.

Klasa ndahet në katër grupe, për të analizuar mesazhet, sipas tematikave të përcaktuara.

Secili nga grupet flasin për mesazhin e pjesëve të "Letërçarkores", duke zbërthyer vlerat njerëzore, morale, kombëtare dhe popullore të lirisë, paqes, luftën kundër rrezikuesve të këtyre vlerave etj.

Mësues-i/ja u sugjeron nxënësve që në formë të përmbledhur të flasin për mesazhet e temave që trajtohen në "Letërçarkore", siç janë: liria-rrezikimi dhe mbrojtja e saj, ndëshkimi i

të mbrapshëve-funksionimi i ligjeve të shtetit, lavdia e nderi për paqedashësit e liridashësit.

**Përforcim:** stuhi mendimi

Mësues-i/ja dhe nxënësit me anë të pyetje-përgjigjeve bëjnë përsëritjen në formë të përmbledhur të domethënies, përmbajtjes dhe mesazheve themelore të tekstit, siç janë vlera e lirisë, mirëkuptimit, e paqes midis njerëzve dhe efektet negative të mosrespektimit të tyre.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Lënda:** Gjuhë shqipe e letërsi

**Klasa:** IX

**Njësia mësimore:** Honore de Balzak - Vdekja e Gorioit

## Veprimtaritë e nxënësit:

- lexojnë pjesët: monologu e njohje si dhe "Vdekja e Gorioit" që gjendet në tekstin mësimor,
- portretizojnë personazhin kryesor Gorioin, duke u ndaluar te ankesat kryesore që ka ai,
- shkruajnë për të mirat dhe efektet negative që sjell paraja, duke përdorur teknikën e pemës së mendimit,
- ndërtojnë pemën e mendimit, duke pasur parasysh tekstin letrar konkret,
- flasin për dukurinë e lakmisë për para duke pasur parasysh mendimet e tyre për këtë dukuri,
- marrin në konsideratë edhe përvojat që i kanë dëgjuar apo lexuar,
- përgjigjen në pyetjet e parapara në tekstin mësimor për këtë njësi mësimore.

Metodat dhe teknikat e realizimit: lexim i tekstit, pema e mendimit, pyetje-përgjigje

## Arritjet e të nxënit:

Nxënësit kanë krijuar shkathtësi për të bërë tipizimin e personazhit të Gorioit, përkatësisht të njeriut që ndjehet i humbur dhe i pashpresë në botën që bazohet mbi pushtetin e parasë dhe humbjes së ndjenjave njerëzore të dashurisë, mirësisë e përkrahjes.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, libri i mësuesit në internet

## Struktura e orës së mësimi

Përgatitje për orën mësimore: lexim i tekstit

Në fillim të orës në tekstin mësimor të gjithë nxënësit lexojnë pjesët: monologu dhe njohje, f. 53.

Mësues-i/ja angazhon një nga nxënësit që bën lexim shprehës të deklamojë pjesën "Vdekja e Gorioit", kurse të tjerët dëgjojnë me vëmendje. Pas leximit nxënësit portretizojnë personazhin kryesor, duke u ndaluar te ankesat kryesore që ka ai ndaj të bijave të tij.

## Ndërtimi i njohurive të reja: pema e mendimit

Nxënësit do të shkruajnë për të mirat dhe efektet negative që sjell paraja, duke përdorur teknikën e pemës së mendimit.

Parashikohet që nxënësit të kenë si model monologun e tekstit "Vdekja e Gorioit", mendimet e tyre për të mirat, si mjet i nevojshëm për jetesë dhe të këqijat e parasë, nëse ajo bëhet qëllim në vetvete.

Nxënësit përmes mendimeve dhe fjalive të tyre shprehen për paranë, duke shënuar anët pozitive dhe negative, rreth kësaj fjale të shkruar vertikalisht në tabelë si dhe në fletoret e tyre. Arsyetojnë mendimet e tyre të cilat i shprehin.

Pemët e mendimit mund të duket kështu:

Paraja është e domosdoshme.	P	Paraja është e parëndësishme.
Paraja të zbukuron jetën.	A	Paraja prish dashurinë midis njerëzve.
Gjithçka sillet rreth parasë.	R	Paraja prish njeriun.
Paraja shpon detin.	A	Paraja prish vëllain me vëlla.
Pa pare nuk hyn hoxha n' minare.	J	Kurrë s' u ngop me para.
Paraja të jep gjithçka edhe vajzat.	A	Shëndet e para!

**Përforcim:** pyetje-përgjigje

Mësues-i/ja u sugjeron nxënësve që të përgjigjen në pyetjet që gjenden në tekstin mësimor për këtë mësim, në kuadër të rubrikës pas fragmentit të tekstit letrar.

**Detyrë shtëpie:**

“Të mirat dhe të këqijat e parasë”.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Lënda:** Gjuhë shqipe e letërsi

**Klasa:** IX

**Njësia mësimore:** Fatos Kongoli - **Ne të tre**

## Veprimtaritë e nxënësit:

- lexojnë fragmentin e romanit "Ne të tre", nga Fatos Kongoli,
- lexojnë edhe përkufizimin për romanin në tekstin shkollor,
- realizojnë teknikën DRTA, duke u përgjigjur pyetjeve për secilin paragraf,
- parashikojnë zhvillimet logjike dhe të parafytyruara pas fragmenteve të lexuara,
- shkruajnë mendimet (komentet) e tyre për dy fragmentet e zgjedhura, për ndryshimet midis të moshuarve dhe të rinjve,
- përgjigjen në pyetjet e parashikuara për këtë njësi mësimore në tekstin shkollor,
- kthejnë fragmentin e tekstit nga ligjërata e drejtë në ligjëratë të zhdrejtë.

Metodat dhe teknikat e realizimit: lexim i fragmentit, DRTA, ditari dypjesësh, pyetje-përgjigje.

## Arritjet e të nxënit:

Nxënësit kanë arritur të interpretojnë fragmentin e tekstit të romanit përkatës, si dhe kanë njohuri të dallojnë pikëpamjet e ndryshme, midis të moshuarve e të rinjve në tekstin e zgjedhur si model për këto dallime.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, përvojat e nxënësve.

## Struktura e orës së mësimimit

Përgatitje për orën mësimore: lexim i fragmentit.

Mësues-i/ja u thotë nxënësve të lexojnë fragmentin e romanit "Ne të tre", nga Fatos Kongoli, duke kërkuar që ata të lexojnë edhe përkufizimin për romanin në tekstin shkollor, për të bërë lidhjen midis aspektit praktik dhe teorik të romanit.

## Ndërtimi i njohurive të reja: DRTA

Punohet sipas teknikës DRTA. Mësues-i/ja lexon në mënyrë shprehëse fragmentet e mëposhtme, të cilat janë përcaktuar më përpara. Nxënësit do të përgjigjen në pyetjet përkatëse, të cilat po ashtu janë planifikuar paraprakisht, por edhe dalin në mënyrë të natyrshme, në bazë të komunikimit mësues-nxënës/e.

Paragrafi I: *Shtëpia e Bertit... deri te...Sonte do ta kalojmë bukur.*

Pyetjet: Cilët janë personazhet e moshuar dhe të rinj në këtë fragment?

Gjeni fjalinë në të cilën bëhet përshtkrimi i Doktorit.

Kush pret se do ta kalojnë mirë "sonte"?

Paragrafi II: *Atë çast në dhomë...deri te... picirruke naziqe*

Pyetjet: Për kë thuhet: -*Moj Ina ti qenke bërë goxha vajzë?*

Si vazhdon përshtkrimi i personazhit të Inës dhe çfarë ndryshimi kishte pësuar ajo?

Paragrafi III: *Zbritëm në dhomën... deri te...dhe ndezi një cigare*

Pyetjet: Kush zbret në dhomën e Robertit dhe pse?

Pse njëri nga personazhet thotë: *Shyqyr që shpëtuam?*

Analizoni fjalinë: *Pastaj i vuri kyçin derës dhe ndezi një cigare.*



Paragrafi IV: *Jam unë... deri te...ta shtronin në dru.*

Pyetjet: Kush pyet se pse e kishin mbyllur derën dhe përse?

Për çfarë arsyeje vëllai nuk do të lejojë motrën e tij të marrë pjesë në ditëlindje?

Shpjego kuptimin e frazeologjisë: Edhe sikur ta shtronin në dru, duke pasur parasysh edhe kontekstin në këtë fragment.

Për të kuptuar mirë ndryshimet midis mendësisë, veprimeve dhe sjelljeve në mes dy moshave, përkatësisht shtresave shoqërore: prindërve (të moshuarve) dhe fëmijëve (të rinjve) përdoret teknika e ditarit dypjesësh.

Paragrafi	Komenti im
<p><i>Të moshuarit:</i> <i>-Ja dhe zonja ime e nderuar, - tha ai me zërin e paktë, që s'mund të besojë se dilte nga ai trup i fuqishëm. Atëherë babai u përshëndet me gruan që po rrinte në këmbë aty pranë, si statujë e lashtë. Ajo ishte po aq e gjatë, e hollë, me flokë të mbledhur prapa.</i></p> <p><i>Të rinjtë:</i> <i>- E di ç'ke ti? Zhduku që aty, po qe se nuk do të hash ndonjë të mirë.</i> <i>- Nuk iki! - u përgjigj vajza me kryeneçësi.</i> <i>- Po s'e hape vete i them babait që po pini duhan. E di vetë pastaj.</i> <i>- Moj, po do ikësh ti? - turfulloi Ylli. - Mace e dreqit.</i> <i>Nuk iki! – këmbënguli Ina me një ton aq kategorik, sa s'linte shteg për asnjë dyshim, se ajo do të tundej që aty, edhe sikur ta shtronin në dru.</i></p>	

#### **Përforcim:** stuhi mendimi

Mësues-i/ja u shtron pyetje nxënësve që janë në tekst mësimor për njësinë përkatëse mësimore. Ata, varësisht nga koha në dispozicion kryejnë detyrën për kthimin e tekstit nga ligjërata e drejtë në ligjëratë të zhdrejtë.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Lënda:** Gjuhë shqipe e letërsi

**Klasa:** IX

**Njësia mësimore:** Mehmet Kraja - Burgu

## **Veprimtaritë e nxënësit:**

- shikojnë incizimin në video të përgatitur më përpara, që është i përbërë nga kuadro të një burgu përjashta dhe mjedisi që e rrethon,
- shkruajnë disa fjali që lidhen me pamjet që kanë parë,
- lexojnë disa nga shkrimet e tyre pa i paragjykuar,
- lexojnë në mënyrë shprehëse dhe kuptimplote tregimin "Burgu" nga Mehmet Kraja,
- bëjnë zgjedhjen e nga një paragrafi secili/a, që sipas tyre përmbledh temën e tregimit,
- shkruajnë mendimet e tyre për fragmentet e zgjedhura,
- pëbëjnë analizë krahasuese të fragmentit të zgjedhur nga tregimi në tekstin mësimor me vargjet përkatëse të Migjenit,
- krahasojnë burgun dhe burgosjen në tregim dhe si e shohin vetë ata,
- përgjigjen në pyetjet për njësinë mësimore përkatëse në tekstin shkollor.

Metodat dhe teknikat e realizimit: shikim i pamjeve video, shkrim i lirë, lexim i tregimit, ditari dypjesësh, diskutim, pyetje-përgjigje.

## **Arritjet e të nxënit:**

Kanë analizuar nocionin e burgosjes në kuptimin e ngushtë dhe të gjerë të fjalës, duke bërë krahasimin midis burgosjes fizike dhe asaj shpirtërore ose mungesës së lirisë, kur ekziston një liri formale, por jo në kuptimin e plotë të fjalës.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, libri i mësuesit në internet, përvojat e nxënësve

## **Struktura e orës së mësimi**

Përgatitje për orën mësimore: shikim i pamjeve video, shkrim i lirë.

Nxënësit shohin kuadro pa zë, por me një muzikë të përshtatshme në një video në projektor. Këto kuadro që janë përzgjedhur më përpara pasqyrojnë oborrin e një burgu, në të cilin shihet burgu përjashta, si dhe mjedisi për rreth ku bien në sy hekurat e dyerve dhe dritareve, ndonjë rojtar burgu, si dhe rruga në afërsi të burgut, ku mbizotëron boshllëku. Nxënësit shkruajnë në 4-5 fjali mbresat që u krijojnë pamjet dhe disa nga ata lexojnë shkrimet e tyre pa i paragjykuar.

## **Ndërtimi i njohurive të reja:**

Disa nga nxënësit lexojnë tregimin në mënyrë shprehëse, kurse pas kësaj secili në mënyrë individuale, gjejnë nga një fragment të zgjedhur që për mendimin e tyre përfshin boshtin e temës së tregimit.

Paragrafi	Komenti im
<p><i>Kur e hapja perden e dritares, në vend që të shikoja qiellin dhe peizazhin e zverdhur nën të, siç bëja zakonisht, në dritaren time pash hekura të kryqëzuar, hekura të ndryshkur, hekura të vënë shpejt e shpejt dhe të përforcuar anash pas murit të shtëpisë”.</i></p>	
<p><i>...Hetova se si pak nga pak (diku thellë, në atë errësirën e pambërritshme të mendimit), vdiste tek unë ideja se mund të dilja që andej. Nuk provova ta hap as derën e shtëpisë, sepse mendja më thoshte se edhe atje, përtej saj, duhej të ishte po ai kryqëzim hekurash.</i></p>	

**Përforcim:** diskutim, pyetje-përgjigje

Mësues-i/ja me nxënës/e bën përmbledhjen e kësaj njësie mësimore, duke ballafaquar mënyrën sesi e kuptojnë burgun nxënësit dhe si e paraqet shkrimtari në tregimin me të njëjtin emër. Gjatë kësaj faze nxënësit u përgjigjen pyetjeve dhe kërkesave në tekstin mësimor.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Lënda:** Gjuhë shqipe e letërsi

**Klasa:** IX

**Njësia mësimore:** Gi dhe Mopasan - Ai

## **Veprimtaritë e nxënësit:**

- lexojnë tregimin në mënyrë individuale,
- diskutojnë për temën dhe personazhet e tregimit,
- përdorin teknikën e diagramit të Venit, teknikë e cila shquan dallimet (anët e veçanta) dhe ngjashmet (të përbashkëtat) e dy proceseve,
- vënë përballë personazhin që rrëfen, që është në vetën e parë dhe personazhin tjetër, që është në vetën e tretë,
- flasin për dallimet midis personazheve,
- flasin për anët e përbashkëta të tyre,
- përgjigjen në pyetjet e tekstit mësimor që janë paraparë për këtë tregim.

Metodat dhe teknikat e realizimit: leximi i tregimit, diskutim, diagrami i Venit, pyetje-përgjigje

## **Arritjet e të nxënit:**

Kanë arritur të bëjnë interpretimin e anëve të përbashkëta dhe dalluese të dy personazheve të tregimit. Kanë sprovuar të bëjnë jo vetëm këtë interpretim, por edhe një tjetër që ka për bazë interpretimin e këtyre dy personazheve si një të vetëm: uni dhe ndërdija e tij.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, libri i mësuesit në internet, tregime të zgjedhura nga Mopasani.

## **Struktura e orës së mësimin**

Përgatitje për orën mësimore: lexim i tregimit, diskutim

Mësues-/ja u sugjeron nxënësve që secili/a në heshtje të lexojnë tregimin dhe më pastaj diskutojnë për dy personazhet dhe temën e tregimit, duke u shprehur lirshëm.

## **Ndërtimi i njohurive të reja:** diagrami i Venit

Për të analizuar tregimin e Gi dhe Mopasani "Ai" është i përshtatshëm diagrami i Venit, teknikë e cila shquan dallimet (anët e veçanta) dhe të ngjashmet (të përbashkëtat) e dy proceseve, dukurive, nocioneve, personazheve, periudhave etj. Në rastin konkret vihen përballë dy personazhe: personazhi që rrëfen, që është në vetën e parë Unë dhe personazhi në sfond, që më shumë është një shpikje e personazhit kryesor që është veta e tretë: Ai.

Unë (të veçantat): real, i dukshëm, i ndjeshëm, i frikësuar, i tmerruar, i torturuar, personazh në vetën e parë, personazh që të vjen keq për të.

Të përbashkëtat: personazhe të të njëjtit tregim, obsesivë, personazhe të tregimit, ndjekin njëri-tjetrin, uni dhe vetëdija.

Ai (të veçantat): real dhe jo real, i dukshëm dhe i padukshëm, hije, mister, halucinacion, i frikshëm, miku i (pa) dukshëm, torturues, personazh në vetën e tretë, personazh që të ngjall frikë, personazh hije.

Duke pasur parasysh përcaktimet që u janë bërë dy personazheve, përkatësisht të përbashkëta të tyre, përgjigjuni në këto pyetje:

Cilat janë tiparet kryesore të dukjes së jashtme të këtyre personazheve?

Bëni përshkrimin psikologjik të personazhit që rrëfen në vetën e parë dhe personazhit që përfaqësohet me emrin Ai. Kush e ka frikë kë dhe pse?

Mësues-i/ja u thotë nxënësve të lexojnë shpjegimet e fjalëve të panjohura, sepse u ndihmojnë në analizën e tregimit.

Për të parë tiparet e këtyre e personazheve, përgjigjen në pyetjet e tekstit mësimor që janë paraparë për këtë tregim. Sidomos zbërtheni pjesën e fragmentit nga tregimi që është përfshirë në kuadër të pikës 12, të nënrubrikës studim teksti. Në këtë fragment Unë dhe Ai janë prodhim i njëri-tjetrit dhe mund të ekzistojnë vetëm së bashku.

**Përforsim:** pyetje-përgjigje, diagrami i Venit

Nxënësit së bashku me mësuesin/en bëjnë pyetje dhe japin përgjigje në formë të përmbledhur se cilat kanë të përbashkëtat dhe të veçantat e dy personazheve të tregimit.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Lënda:** Gjuhë shqipe e letërsi

**Klasa:** IX

**Njësia mësimore:** Anton Zako Çajupi - **Katërbëdhjetë vjeç dhëndër**

## **Veprimtaritë e nxënësit:**

- lexojnë të dhënat për jetën dhe krijimtarinë e shkrimtarit,
- flasin për krijimtarinë e tij, posaçërisht veprimtarinë dramatike,
- lexojnë në tërësi fragmentin e komedisë "14 vjeç dhëndër".
- caktojnë tri tema themelore të kësaj komedie: pozita e gruas, pozita e burrit, martesat e hershme,
- gjejnë fragmentet që pasqyrojnë më së miri këto tri tema,
- ndahen në tri grupe; secili grup analizon njërin nga temat, duke iu referuar fragmentit letrar përkatës, përvojës personale dhe njohurive që kanë përgjithësisht për temat.
- punojnë sipas teknikës së ditarit dypjesësh,
- u përgjigjen pyetjeve për këtë njësi mësimore që janë në tekstin mësimor,
- diskutojnë për aktualitetin e temave që trajtohen në komedinë përkatëse: martesat e hershme dhe pozitat e (pa)barabarta midis burrit dhe gruas.

**Metodat dhe teknikat e realizimit:** lexim, diskutim, analizë e tekstit të zgjedhur, punë në grupe, ditari dypjesësh, pyetje-përgjigje

## **Arritjet e të nxënit:**

Kanë realizuar analizën e tekstit përkatës, përkatësisht të temave themelore të tij, duke iu referuar fragmentit të komedisë, përvojës personale dhe njohurive të tjera të përgjithshme.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, libri i nxënësit në internet, komeditë e Çajupit.

## **Struktura e orës së mësimimit**

Përgatitje për orën mësimore: lexim, diskutim

Nxënësit lexojnë të dhënat për shkrimtarin Anton Zako Çajupi dhe veprat e tij si dhe së bashku me nxënësit, në mënyrë të përmbledhur flasin, sidomos për krijimtarinë e tij në fushën e dramaturgjisë.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** analizë e tekstit të zgjedhur, punë në grupe, ditari dypjesësh

Mësues-i/ja u thotë nxënësve të lexojnë në tërësi fragmentin e komedisë "Katërbëdhjetë vjeç dhëndër". Në bashkëpunim midis nxënësve dhe mësues-it/es caktohen tri tema themelore të kësaj komedie: pozita e gruas, pozita e burrit, martesat e hershme. Gjenden fragmentet që pasqyrojnë më së miri këto tri tema; klasa ndahet në tri grupe. Secili grup analizon njërin nga temat, duke iu referuar fragmentit letrar përkatës, përvojës personale dhe njohurive që kanë përgjithësisht për temat.

Konkretisht kjo pjesë e punës mund të zhvillohet sipas kësaj skeme:

Fragmentet e nxënësit mund t'i zgjedhin në bashkëpunim me mësues-i/en, kurse analizat i bëjnë grupet përkatëse, në formë të pavarur.

Fragmenti	Analiza e nxënësve
<p>Grupi i parë: pozita e gruas Tana <i>Gjithë ditën ç'keshe bërë? Ti për bare e për dru s'vete dhe qahesh se nuke flete? Tërë ditën ngas qetë Dhe drek' e darkë bëj vetë, Gjithë puna përmi mua!</i></p> <p>...</p> <p>Grupi i dytë: pozita e burrit Vangjeli (me inat) <i>Mos më bën të të godit. Se zakonë s'e harrova, sonte shumë të durova. Nga hunda s'më heq dot kurrë, se nuk' jam si çdo burrë! Jam shqipëtar i vërtetë, do të bëj si dua vetë!</i></p> <p>...</p> <p>Grupi i tretë: martesat e hershme Tana <i>Kjo punë s'bënetë kurr, po djali na u burrë. Ndaj të lutem ta martojmë, erdhi dita të gëzojmë. Ne pa nuse pse të rrimë? Kur të kem nusenë ndihmë, punët bënenë vetë, nukë rrojmë me jetë! Pse s'më flet?</i></p> <p>Vangjeli <i>Ç'të them, moj grua? Çuditë me ç'fjalë thua! Katërbëdhjetë vjeç djalë do ta martosh?</i></p>	

**Përforsim:** pyetje-përgjigje, diskutim

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve për këtë njësi që janë në tekstin mësimor. Ata diskutojnë për aktualitetin e temave që trajtohen në komedinë përkatëse: martesat e hershme dhe pozita e (pa)barabartë midis burrit dhe gruas.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Lënda:** Gjuhë shqipe e letërsi

**Klasa:** IX

**Njësia mësimore:** Sami Frashëri - Besa

## **Veprimtaritë e nxënësit:**

- shprehen se a e mbajnë fjalën e dhënë,
- diskutojnë për shkallën më të lartë të fjalës së dhënë-besën,
- përdorin pemën e mendimit, duke u shprehur për asociacionet e besës,
- diskutojnë për përhapjen e besës dhe tradhtisë në mendësinë, kulturën, letërsinë dhe artin,
- përmes teknikës DRTA analizojnë fragmentet nga drama "Besa",
- fillimisht dëgjojnë fragmentin e lexuar dhe më pastaj përgjigjen në pyetjet e mësues-it/es,
- punojnë detyrën e shtëpisë me temën "Besa e shqiptarëve, institucion mendësie, kulture e trashëgimie".

Metodat dhe teknikat e realizimit: bashkëbisedim, pema e mendimit, DRTA, detyrë shtëpie

## **Arritjet e të nxënit:**

Përmes teknikave të përdorura, nxënësit kanë krijuar shkathtësi e njohuri për të analizuar dhe kuptuar temën e besës, përkatësisht mënyrës sesi mbahet ajo në veprën përkatëse, duke flijuar krijesën më të shtrenjtë, që është fëmija, si dhe kanë arritur të njohin tiparet e personazheve kryesore.


**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, libri i nxënësit në internet

## **Struktura e orës së mësimimit**

Përgatitje për orën mësimore: bashkëbisedim, pema e mendimit

Mësues-i/ja fillon bashkëbisedimin me nxënësit duke i pyetur se a e mbajnë fjalën. Pas përgjigjeve të lira të nxënësve, mësues/i/ja shtron pyetjen si quhet ndryshe fjala e dhënë. Nëse është e nevojshme vetë mësues-i/ja e sugjeron fjalën besë. Përdoret pema e mendimit për të dhënë sesi kuptohet besa për shqiptarët, në të kaluarën dhe sot.





### Ndërtimi i njohurive të reja: DRTA

Përdoret teknika DRTA. Mësues-i/ja ose ndonjë nga nxënësit lexojnë fragmentet e zgjedhura me ndalesa. Gjatë ndalesave, mësues-i/ja shtron pyetje për fragmentet, kurse nxënësit përgjigjen.

Paragrafi I. -Ah! Mëmëza ime... deri te...ndonjë anë fare!...

Pyetjet: Kush do t'ia marrë gjakun e burrit Vahidesë?

Ç'janë besa dhe gjakësori dhe pse janë të lidhura?

Paragrafi II. -Djali!... bir i vetëm!... deri te...Djalin tënd!...

Pyetjet: Çfarë marrëdhëniesh familjare ka Fetahu me atë që do ta vrasë për të marrë gjakun?  
Nga çfarë emocionesh tundohet Fetahu, kur thotë: *Me dorën time...A!... Jo... s'guxoj dot...* (pasi mendohet pak). Po fjala?... beja që bëra?... Besa që lidha?  
Kush pendohet menjëherë pas vrasjes që bën dhe pse?

Paragrafi III. -*T'ia bësh ti!...deri te... Edhe mëmën ta doni.*

Pyetjet: Shpjegoni këtë fjali që e thotë personazhi i Vahidesë: Një që zgjat dorë mbi dritën e syrit, është më i keq se një egërsirë.

Shpjegoni kundërpërgjigjen: *Nga një që s'mban fjalën, nga një që prish benë, nga që s'ruan nderin; kjo është një mijë herë më e lehtë.*

**Përforcim:** detyrë shtëpie

**Detyrë shtëpie:**

Mësues-i/ja u jep nxënësve detyrë shtëpie me temën "Besa e shqiptarëve, institucion mendësie, kulture e trashëgimie".

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Lënda:** Gjuhë shqipe e letërsi

**Klasa:** IX

**Njësia mësimore:** Branislav Nushiç - **Personi i dyshimtë**

## **Veprimtaritë e nxënësit:**

- në bashkëpunim me mësues-in/en bëjnë ndarjen e roleve, sipas prirjes dhe dëshirës, marrin të përgatisin për lexim tekstin e personazheve (roleve) të komedisë përkatëse
- përgatitja e këtyre roleve, që deklamimi të jetë sa më i përgatitur, mund të jepet si detyrë shtëpie, një orë përpara se kjo njësi të realizohet në klasë.
- janë të vëmendshëm dhe përqendrohen në personazhet kryesore: Gjoka, Viqa, Kapiteni dhe në temën kryesore,
- ndahen në katër grupe, duke u kujdesur që përbërja e grupeve të jetë e harmonizuar,
- tri grupet e para analizojnë tri personazhet kryesore,
- grupi i katërt, analizon temën e këtij fragmenti dhe përgjithësisht të komedisë,
- secili nga grupet lexon tekstin e personazheve, përkatësisht, fragmentin në tërësi dhe përgatiten të flasin veçoritë e tyre,
- grupet bëjnë prezantimin e punës së tyre përpara klasës.

Metodat dhe teknikat e realizimit: leximi i ndarë në role, analizë e temës dhe e personazheve

## **Arritjet e të nxënësve:**

Kanë krijuar aftësi të analizojnë dhe prezantojnë veçoritë e tyre për nga karakteri social dhe psikologjik si dhe të flasin për temën dhe kompozicionin e komedisë përkatëse, duke u përqendruar në interpretimin e raportit shtet-qytetar.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, libri i mësuesit

## **Struktura e orës së mësimimit**

Përgatitje për orën mësimore: leximi i ndarë në role

Në fillim të kësaj periudhe të orës, nxënësit në bashkëpunim me mësues-in/en bëjnë ndarjen e roleve (nxënësit sipas prirjes dhe dëshirës) marrin të përgatisin për lexim tekstin e personazheve (roleve) të komedisë përkatëse. Përgatitja e këtyre roleve, mund të jepet si detyrë shtëpie, një orë para se kjo njësi të realizohet në klasë. Përpara se të bëhet leximi mësues-i/ja u tërheq vëmendjen nxënësve që të përqendrohen në personazhet kryesore: Gjoka, Viqa, Kapiteni dhe në temën kryesore.

**Ndërtimi i njohurive të reja:** leximi i ndarë në role, analizë e temës dhe personazheve

Mësues-i/ja në bashkëpunim me nxënësit ndan klasën në grupe, duke u kujdesur që përbërja e grupeve të jetë e harmonizuar aq sa është e mundur me cilësitë e nxënësve dhe përbërjen gjinore.

Grupi i parë merr përsipër të analizojë personazhin e Viqës.

Grupi i dytë analizon personazhin e Gjokës.

Grupi i tretë analizon personazhin e Kapitenit.

Grupi i katërt analizon temën e këtij fragmenti dhe përgjithësisht të komedisë.

Secili nga tri grupet punon, duke u bazuar në tekstin që e flasin personazhet përkatëse. Këtë e arrijnë me anë të leximit dhe të rileximit të tekstit gjegjësisht të personazheve dhe pastaj

merren me zbulimin e veçorive, përkatësisht tipizimin e tyre. Grupi i katërt lexon e rilexon tërë fragmentin, duke u përqendruar te tema e komedisë, përkatësisht në raportin e pushtetit ndaj qytetarit. Ky grup ka parasysh edhe pyetjet që janë bërë për fragmentin e komedisë në tekstin mësimor, në faqet 76, 77.

**Përforcim:** diskutim

Në pjesën përmbyllëse të kësaj njësie mësimore, nxënësit me ndihmën e mësues-it/es diskutojnë se çfarë ndikimi ka komedia te publiku; a ndikon ajo vetëm për të qeshur, apo edhe për korrigjuar veset tona (për ndikimin e fundit shkruhet edhe në tekstin mësimor).

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**Lënda:** Gjuhë shqipe e letërsi

**Klasa:** IX

**Njësia mësimore:** Uiliam Shekspir - **Romeo e Zhuljeta**

## **Veprimtaritë e nxënësit:**

- përgatisin më përpara vënien në skenë të fragmentit që është në tekstin mësimor të tragjedisë "Romeo e Zhuljeta",
- bëhet zgjedhja e nxënësve që të do të luajnë Romeon dhe Zhulietën,
- angazhohen për të realizuar skenografinë e kostumografinë,
- në bashkëpunim me mësues-in/en përgatisin rolet e Romeos dhe Zhulietës,
- japin fragmentin e pjesës teatrale para klasës,
- përdorin teknikën e pemës së mendimit për të zbërthyer tekstin dramatik,
- në anën e majtë të pemës së mendimit bëjnë zbërthimin tematik, përmbajtjesor dhe të personazheve,
- në anën e djathtë gjejnë figurat kryesore stilistike dhe flasin për pasurinë e gjuhës së përkthimit të veprës,
- diskutojnë së bashku me mësues-in/en sesi do të punohet detyra e shtëpisë me temën gje gjëse.

Metodat dhe teknikat e realizimit: inskenimi i pjesës teatrale, pema e mendimit, detyrë shtëpie

## **Arritjet e të nxënësit:**

Nxënësit kanë përgatitur dhe dhënë pjesën e fragmentit të shfaqjes teatrale përpara klasës si dhe kanë zbërthyer anën përmbajtjesore dhe strukturore të saj, duke përdorur metodat e teknikat e përshtatshme për të realizuar këto synime.

**Mjetet mësimore:** teksti mësimor, libri i mësuesit, vepra "Romeo e Zhuljeta"

## **Struktura e orës së mësimimit**

Përgatitje për orën mësimore: inskenimi i fragmentit, dhënia e pjesës teatrale


Mësues-i/ja në bashkëpunim me nxënës-it/et kanë përgatitur më përpara vënien në skenë të fragmentit që është në tekstin mësimor të tragjedisë "Romeo e Zhuljeta". Në bazë të prirjes dhe dëshirës bëhet zgjedhja e një nxënësi që do të luajë rolin e Romeos dhe një nxënëse që do të luajë rolin e Zhulietës. Rolet përgatiten në bashkëpunim me mësues-in/en, por edhe nxënësit e tjerë japin idetë e tyre. Nxënësit e tjerë, sipas prirjeve japin mendime dhe kontribute për skenën, muzikën si dhe kostumet që do të përdoren gjatë interpretimit të roleve.

Pasi janë bërë të gjitha përgatitjet në klasë: bëhet gati skena, skenografia, vishen aktorët me kostumet e parapara, vendi se ku do të qëndrojë publiku (nxënësit dhe mësuesi) që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në shfaqje dhe bëhet dhënia e shfaqjes.

## **Ndërtimi i njohurive të reja:**

Kjo pjesë e orës fillon me dhënien e mendimeve nga nxënësit për shfaqjen teatrale. Mësues-i/ja u thotë nxënësve për të bërë analizën e fragmentit të tragjedisë "Romeo e Zhuljeta", duke përdorur pemën e mendimit.

Dashuri rinore



**Përforcim:** detyrë shtëpie

**Detyrë shtëpie:**

Jepet detyra e shtëpisë me titullin "Romeo e Zhulieta, simbol i dashurisë ideale". Për të punuar këtë detyrë mësues-i/ja u sugjeron nxënësve të shikojnë shfaqjen teatrale "Romeo e Zhulieta" që mund të gjendet lehtë në internet.